



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr.97 dt.27.08.2001

**PER
MIRATIMIN E PROJEKT-BUXHETIT TE VITIT 2002 PER BASHKINE TIRANE**

Në mbështetje të nenit 19 të ligjit Nr.8652 dt.31.07.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” si dhe ligjit Nr.8654 dt.31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Bashkisë Tiranë”, ligjit Nr.8379 dt.29.07.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë”, ligjit Nr.7776 dt.22.12.1993 “Për buxhetin lokal” ndryshuar me ligjin Nr.8399 dt.29.07.1998, udhëzimit Nr.4 dt.13.07.2002 të Ministrisë së Pushtetit Lokal, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Tiranë, Këshilli Bashkiak

V E N D O S I

1. Të miratojë projekt-buxhetin e Bashkisë Tiranë për vitin 2002 sipas tabelave bashkëngjitur
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Burimeve Ekonomike, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Njerëzore & Informacionit, Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike dhe Drejtoria Juridike
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KRYETARI

Leonidha TOSKA